

DIALOGU ME SERBINË: SFIDA E ÇDO QEVERIE

QERSHOR, 2021



DIALOGU ME SERBINË: SFIDA E ÇDO QEVERIE

QERSHOR, 2021

E drejta e autorit © 2021. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike,

përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jo komerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 237
10 000, Prishtinë, Kosovë.
Tel: +383 (0) 38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org

Autore: **Violeta Haxholli**

Layout and design: **envinion**

Kjo analizë është realizuar në kuadër të projektit *"Promovimi i një procesi të mirë informuar dhe pjesëmarrës në fazën finale të dialogut Kosovë-Serbi"*, i mbështetur nga Ambasada Zvicerane në Prishtinë.

Përmbajtja e kësaj analize është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet që reflekton qëndrimet e Ambasadës Zvicerane në Prishtinë.

PËRMBAJTJE

1. Hyrje: Dialogu Kosovë-Serbi-një historik i shkurtër	4
2. Efektet e procesit të dialogut në aspektin e brendshëm	9
3. Dialogu në programin e qeverisë 'Kurti II'	1
4. Përfundime dhe Rruga përpara	13



1. Hyrje: Dialogu Kosovë-Serbi-një historik i shkurtër

Me 8 mars të vitit 2021 është bërë një dekadë që nga fillimi i dialogut mes Kosovës dhe Serbisë. Ky proces që u shndërrua në sfidë për secilën qeveri në Kosovë, ishte imponuar nga një **rezolutë e Asamblesë së Kombeve të Bashkuara** që u miratua me 9 shtator 2010,¹ dy muaj pas opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për pavarësinë e Kosovës. Shteti serb i indinjuar nga opinioni i GjND-së², i cili konkludoi se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, ndërmori një fushatë të re për të kundërshtuar statusin e ri të Kosovës. Kështu Serbia propozoi një rezolutë në OKB, e cila bënte thirrje për një dialog me Kosovën siç shkruhej në këtë dokument, "**për të gjitha çështjet e hapura**", duke përfshirë edhe statusin e Kosovës.³ Të vetëdijshëm për papërshtatshmërinë e këtij termi shtetet aleate të Kosovës në OKB, SHBA-të dhe shtete anëtare të BE-së arritën të modifikojnë këtë rezolutë nga "**dialog për të gjitha çështjet e hapura**" në "**dialog për lehtësimin e jetës së qytetarëve dhe integritimin e dy vendeve në BE**". Mbi bazën e kësaj rezolute takimi i parë i dialogut filloi në mars 2011 në Bruksel me lehtësimin e përfaqësuesit të BE-së Robert Cooper.

Nga kjo **fazë e parë e dialogut**, që u definua si proces teknik, Kosova dhe Serbia u dakorduan për **shtatë konkluzat** për çështje si lëvizja e lirë, regjistrat civil, regjistrat kadastral,



Nga kjo fazë e parë e dialogut, që u definua si proces teknik, Kosova dhe Serbia u dakorduan për shtatë konkluzat për çështje si lëvizja e lirë, regjistrat civil, regjistrat kadastral, IBM-i, përfaqësimi rajonal, njohja reciproke e diplomave dhe vula doganore

IBM-i, përfaqësimi rajonal, njohja reciproke e diplomave dhe vula doganore. Statusi i këtyre dokumenteve nuk ishte i qartë pasi ato nuk u nënshkruan nga palët dhe nuk kaluan

¹ Rezoluta e OKB-së për dialogun Kosovë-Serbi, "A/RES/64/298", 9 shtator 2010 në, http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/64/298

² Opinioni i GjND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës, 22 korrik 2010 në, <https://www.icj-cij.org/files/case-related/141/141-20100722-ADV-01-00-EN.pdf>

³ REUTERS, "Serbia mbështet rezolutën e kompromisit të OKB-së për Kosovën" (org. title "Serbia backs compromise U.N. resolution on Kosovo"), 9 shtator 2010 në, <https://www.reuters.com/article/us-serbia-kosovo-un-idUUSTRE6885J20100909>



nëpër procese të ratifikimit. Edhe gjuha e përdorur në to ishte dykuptimëshe, dukuri kjo që i përcolli edhe marrëveshjet tjera të dialogut në vijim. Kjo gjuhë e linte interpretimin e termeve në diskrecion të palëve duke u mundësuar “rrugëdalje” para kundërshtarëve të marrëveshjeve dhe qytetarëve. Faza e parë e dialogut u përmbyll me një marrëveshje të rëndësishme, atë për përfaqësimin dhe bashkëpunimin rajonal përmes së cilës Kosova u dakordua që në këto mekanizma të prezantohej me një **fusnotë** e cila nuk e paragjykonte statusin dhe thirrjet në opinionin e GJND-së dhe Rezolutën 1244.⁴

Në tetor të vitit 2012, **dialogu teknik hyri në një fazë të re** që perceptohej dhe definohej si **proces politik**, pasi një gamë e re e çështjeve u përfshinë në tryezën e diskutimit. Këto kishin në fokus shtyllat e brendshme të shtetit të Kosovës dhe ndërlidhjen e tyre me integrimin e komunitetit serb në vend. Edhe pala lehtësuese BE e ngriti nivelin e përfaqësimit në nivel të Përfaqësueses së Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri, ndërsa palët tani do të takoheshin **në nivel të kryeministrave e presidentëve**. Vetëm disa muaj pas fillimit të kësaj faze të dialogut, u arrit një nga marrëveshjet më të rëndësishme, **Marrëveshja e Parë e Parimeve për Normalizimin e Marrëdhënieve** mes Kosovës dhe Serbisë.⁵ Pjesa kryesore dhe më e madhe e dokumentit, konkretisht gjashtë pika të tij, parashohin krijimin e një **Asociacioni të Komunave me Shumicë Serbe** me kompetenca të zgjeruara. Ndërsa nëntë pikat e tjera rregullojnë çështje të tjera si drejtësia, siguria, zgjedhjet në veri, financimi nga Serbia, energjia, telekomi dhe rruga drejt BE-së. Marrëveshja **u ratifikua në Kuvendin e Kosovës** me 2/3 e votave të deputetëve në mes kundërshtimeve politike e qytetare, ndërsa nga bartësit e procesit të asaj kohe u përshkrua si historike.

Nga kjo marrëveshje derivuan edhe marrëveshje tjera në kuadër të kësaj faze të dialogut, të cilat definojnë detajet e çështjeve të

dakorduar mes palëve. Një nga derivatet më të rëndësishme ishte Marrëveshja specifike për themelimin e Asociacionit e arritur më 25 gusht 2015. Mes polemikave se ky mekanizëm ishte në kundërshtim me Kushtetutën qysh në vitin 2013 me Marrëveshjen e Parë, marrëveshja e gushtit u dërgua në Gjykatën Kushtetuese për interpretim në tetor të vitit 2015 nga Presidentja e asaj kohe Atifete Jahjaga. Kjo e fundit konkuldoi se përmbajtja e dokumentit nuk ishte në përputhje me Kushtetutën, duke i hapur rrugë krijimit të këtij mekanizmi në përputhje me aktgjykimin dhe me kusht që dekreti i themelimit të dërgohej sërish në Gjykatë për verifikim.⁶ Polemikën që e përfshinë këtë temë i dhanë një kahje të re dialogut në vitet në vijim. **Nga viti 2016 dialogu po konsiderohej se kishte hyrë në një fazë të re**. Në vitet në vijim u tentua që procesit t’i jepej një kurs tjetër, që kulmoi me **idenë e korigjimit të kufijve/shkëmbimit të territoreve** në vitin 2018, si opsion për arritjen e një dakordimi final mes Kosovës dhe Serbisë. Nga kjo periudhë e deri në vitin 2020 procesi u shoqërua me diskutime të ashpra mes spektrit politik. Ndërsa polemikat për shkëmbimin e territoreve duket se u përmbyllën, së paku për një kohë, me arritjen e një marrëveshjeje për normalizim ekonomik në Uashington më 4 shtator 2020.

Vazhdimi i dialogut në vitin 2021 e gjen Kosovën me një Qeveri të re. Kundërshtarët e dikurshëm të këtij procesi, Lëvizja Vetëvendosje, tani gjenden në ballë të procesit me pritjet e ndërmjetësve për të përmbyllur dialogun me një marrëveshje finale dhe ligjërisht të obligueshme. Nuk dihet nëse tema e korigjimit të kufijve/shkëmbimit të territoreve mund të rikthehet si opsion, mirëpo tema e Asociacionit duket se do të jetë një nga pjesët qendrore të këtij procesi. Tani tetë vite pas arritjes së Marrëveshjes së Parë dhe gjashtë vite pas Marrëveshjes së Gushtit, Asociacioni ende nuk është themeluar. Edhe pse Kosova ka bërë disa përpjekje për të filluar procesin e themelimit, nga përfaqësuesit serb ka pasur rezistencë që procesi të bëhet sipas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.⁷ Prandaj pala

4 Shih marrëveshjen për përfaqësim dhe bashkëpunim rajonal në, <http://votaim.org/Public/Dialog>

5 Shih marrëveshjen e parë të parimeve për normalizimin e marrëdhënieve në, <http://votaim.org/Public/Dialog>

6 Shih aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese për Asociacionin në, http://www.votaim.org/Uploads/Data/Documents/VLERES-1_GmystyF653.PDF

7 Kjo është konfirmuar edhe nga pjestarë të shoqërisë civile të komunitetit serb në Kosovë. Për më shumë shih deklaratën e drejtorit të NGO AKTIV Miodrag Miličević në konferencën e KDI-së të mbajtur me 23 qershor 2021 në, <https://fb.watch/6tcAmuSrfn/>

serbe ka kërkuar që kjo çështje të diskutohet dhe të përmbyllet në Bruksel. Përderisa është e qartë se kjo temë do të jetë pjesë e diskutimeve në këtë fazë të dialogut, i paqartë mbetet qëndrimi dhe veprimet e Qeverisë së re të Kosovës për këtë çështje në veçanti, por dhe procesin e dialogut në përgjithësi. Në takimin e 15 qershorit mes kryeministri Kurti dhe Presidentit Vuçiq në Bruksel, që shënoi edhe fillimin e kapitullit të ri të dialogut, Kurti ka paraqitur katër propozime, sipas tij të nevojshme për të ecur përpara me procesin.⁸ Ndërsa lidhur me Asociacionin, krejt çka është thënë deri më tani nga Qeveria është se Asociacioni nuk mund të themelohet mbi baza etnike pasi kjo është në kundërshtim me rendin



Nga viti 2016 dialogu po konsiderohej se kishte hyrë në një fazë të re. Në vitet në vijim u tentua që procesit ti jepej një kurs tjetër, që kulmoi me idenë e korrigjimit të kufijve/shkëmbimit të territoreve.

kushtetues të vendit.⁹ Kurse, kryetarja e grupit parlamentar të LVV-së znj. Mimoza Kusari-Lila ka dekalruar se Qeveria nuk mund të zbatojë dakordimet e më hershme të palëve nëse ato janë konsideruar si të dëmshme nga Gjykata Kushtetuese. Prandaj Qeveria ka ardhur me propozime të reja në vend të tyre siç është ai për krijimin e Këshillit Nacional, në përputhje me Kushtetutën e vendit.¹⁰ Mbetet të shihet se cilët do të jenë hapat e Qeverisë lidhur me këtë çështje dhe dialogun në përgjithësi.

Kjo analizë tenton të vlerësojë qasjen e Qeverisë Kurti ndaj dialogut dhe të ofrojë rekomandime mbi rrugën përpara në këtë proces të rëndësishëm për Kosovën.

8 Kryeministri Kurti në Bruksel ka paraqitur 4 propozime: 1) Avancimi i marrëveshjes CEFTA në marrëveshje SEFTA; 2) Kosova dhe Serbia ta nënshkruajnë një deklaratë të paqes; 3) Largimi i Velko Odaloviq nga delegacioni serb; dhe 4) Reciprociteti bilateral: krijimi i Këshillit nacional për serbët e Kosovës ashtu siç është në Serbi për shqiptarët dhe boshnjakët. Shih detajet në "Deklarimi i kryeministrit Kurti për media në Bruksel", 15 qershor 2021, në <https://kryeministri-ks.net/deklarimi-i-kryeministrit-kurti-per-media-ne-bruksel/>

9 DW, "Kurti: Nuk mund të ketë asociacion komunash mbi baza etnike", 17 qershor 2021 në, <https://www.dw.com/sq/kurti-nuk-mund-t%C3%AB-ket%C3%AB-asociacion-komunash-mbi-baza-etnike/a-57934342>

10 Shih deklaratën e kryetarës së Grupit Parlamentar të LVV-së znj. Mimoza Kusari-Lila në konferencën e KDI-së me 23 qershor 2021 në, <https://fb.watch/6tcAmuSrfn/>



2. Efektet e procesit të dialogut në aspektin e brendshëm

Që nga fillimi i tij, procesi i dialogut ka prodhuar përplasje të ashpra verbale dhe përçarje të thellë mes spektrit politik në vend. Edhe pse të gjitha subjektet politike, kanë qenë në parim pro dialogut me Serbinë, arsye e mospajttimeve kanë qenë marrëveshjet dhe temat që janë ngritur në kuadër të dialogut, ndër to Asociacioni, korigjimi i kufijve dhe masat tregtare ndaj Serbisë. Por përveç kësaj, jo rrallë herë qëndrimet e partive politike ndaj dialogut janë mbajtur nga prizmi i interesave të ngushta partiake. Mund të thuhet se vetëm nga viti 2011 deri në vitin 2013 ka pasur një nivel konsensusi, kur parti të caktuara opozitare në atë kohë kishin mbështetur dialogun duke dërguar përfaqësues në ekipin e Qeverisë¹¹ apo duke votuar Marrëveshjen e 19 prillit e vitit 2013, e cila u ratifikua në Kuvend me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve.

Nga viti 2013 e tutje, partitë politike kryesisht i janë qasur temës së dialogut nga perspektiva e kalkulimeve partiake, duke anashkaluar faktin se kjo çështje prek interesin nacional të Kosovës. Si rezultat, qasja subjektive e partive ka vështirësuar arritjen e konsensusit dhe unitetit politik për këtë temë të rëndësishme. Ka pasur raste kur as kryeministri dhe presidenti si bashkëudhëheqës të politikës së jashtme, respektivisht dialogut si temë që bie në këtë domen,¹² nuk kanë folur me një zë rreth kësaj teme, duke prezantuar qëndrime të ndryshme në takime të dialogut dhe me akterë ndërkombëtarë. Si rezultat, mungesa e një uniteti politik e ka



Që nga fillimi i tij, procesi i dialogut ka prodhuar përplasje të ashpra verbale dhe përçarje të thellë mes spektrit politik në vend.

penalizuar pozicionin e Kosovës në dialog. Sepse qëndrimet e ndryshme që janë shprehur nga përfaqësuesit politik rreth kësaj teme, kanë bërë që të përcohen mesazhe të ndryshme, duke e paraqitur Kosovën si shtet joserioz.¹³

Qasja ndaj dialogut dhe raporteve me Serbinë ishte arsyeja kryesore e rënies së dy qeverive në Kosovë për shkak të çarjeve që kjo temë shkaktoi mes partive në koalicionet qeverisëse. Qeveria Haradinaj ra pas dorëheqjes së kryemnistrit Haradinaj, i cili kishte vendosur tarifën 100% ndaj mallrave të Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës. Për këtë vendim, ai me kohë kishte humbur përkrahjen e partnerit kryesor qeverisës PDK. Pas saj, Qeveria 'Kurti 1' zëvendësoi tarifën 100% me masa të reciprocitetit, vendim ky, për të cilin nuk mori përkrahje nga partneri i koalicionit të asaj kohe LDK.

11 Evropa e Lirë, "Blerim Shala - koordinator i dialogut", 22 nëntor 2012 në, <https://www.evropaelire.org/a/24778466.html>

12 Sipas Kushtetutës kryeministri e udhëheq dialogun në këshillim me Presidentin, dispozita këto që janë sqaruar edhe me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me Ligjin për Delegacionin Shtetëror për Dialogun. Shih aktgjykimin në, https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2019/06/ko_43_19_agj_shq.pdf

13 Shih komunikatën e KDI-së për media, Letër e hapur nga KDI për Presidentin dhe Kryeministrin e Republikës së Kosovës, 26 prill 2019 në, <http://www.votaime.org/Public/DialogActivity/Detail/304>





Eventualisht edhe kjo qeveri ra, pas mocionit të mosbesimit në Kuvend. Në bazë të deklaratave publike të përfaqësuesve të partive, arsyeja e mospërkrahjes së masave ndaj Serbisë kanë qenë kërkesat e partnerëve ndërkombëtarë për heqjen e këtyre masave, në mënyrë që ti hapet rruga vazhimit të dialogut.

Përveç efekteve politike, dialogu si temë ka ndikuar edhe në aspekte tjera të brendshme. Duke qenë një nga sfidat kryesore të secilës qeveri, kjo temë tash e shumë vite ka marrë fokusin kryesor institucional e medial. Për pasojë, temat tjera me interes publik kanë mbetur në hije, sidomos në periudha kur zhvillimet rreth dialogut kanë qenë lajmi qendror, duke lënë përshtypjen se çdo të tjetër në vend ishte ndalur për t'i shërbyer këtij procesi. Në ndërkohë Kosova ka vazhduar të ketë sfida tjera si korrupsioni, papunësia, shkalla e ulët e zhvillimit ekonomik, migrimi etj.

Mirëpo, dialogu vazhdon të mbetet një temë që ia arrin të dalë në krye të agjendës edhe kur qeveritë nuk preferojnë të merren me të. Kjo u pa me rastin e Qeverisë së re 'Kurti 2', e cila qysh në fushatë elektorale kishte deklaruar se dialogun nuk do ta kishin në fokus, pasi kjo temë listohej poshtë mes prioriteteve të qytetarëve. Ky qëndrim u reflektua edhe në programin e kësaj qeverie, i cili do të trajtohet më gjerësisht në kapitullin në vijim.



Qasja ndaj dialogut dhe raporteve me Serbinë ishte arsyeja kryesore e rënies së dy qeverive në Kosovë për shkak të çarjeve që kjo temë shkaktoi mes partive në koalicione qeverisëse.



3. Dialogu në programin e qeverisë 'Kurti II'

Që dialogu me Serbinë do të vazhdonte të ishte një nga sfidat kryesore, u bë e evidente sapo Qeveria 'Kurti 2' mori detyrën në mars të këtij viti. Kjo sepse vazhdimi i dialogut ishte një nga kërkesat e para të partnerëve ndërkombëtarë. Megjithatë, partia në pushtet e anashkaloi këtë temë duke e renditur poshtë në listën e prioriteteve qeverisëse. Rrjedhimisht, në programin e Qeverisë nënkaptulli për dialogun me Serbinë është i vendosur në fund të programit, konkretisht në faqe 55 dhe 56 të këtij dokumenti 60 faqësh. Aty thuhet se Kosova është e gatshme ta njohë Serbinë nëse kjo e fundit e njeh Kosovën dhe distancohet nga kërcenimet ndaj Kosovës e fqinjëve, ndërhyrjet dhe gjuha nacionaliste e raciste.¹⁴ Më tej në këtë program thuhet se Kosova në bashkëpunim me partnerët amerikanë e evropianë do të përpiqet për arritjen e normalizimit të marrëdhënieve, njohjen e ndërsjellë dhe mirëmbajtjen e raporteve me Serbinë mbi baza të reciprocitetit. Lidhur me këtë, nuk është i qartë se a nënkupton kjo vendosjen e reciprocitetit politik e tregtar ndaj Serbisë, siç ka ndodhur në Qeverinë Kurti 1, apo pas arritjes së marrëveshjes finale.

Në program nuk përmenden temat konkrete që Qeveria synon t'i diskutojë në dialog por vetëm thuhet se, në dialog do të adresohen çështjet ndërshtetërore dhe të fqinjësisë së mirë dhe orientim kryesor janë përfitimet e qytetarëve nga rezultatet e dialogut. Po ashtu, përcaktohet që marrëveshja finale e synuar do të ketë brenda të gjitha çështjet e pazgjidhura që nga suksesioni i ish Federatës Jugosllave. Më tutje në këtë program thuhet se Qeveria planifikon që t'i vlerësojë marrëveshjet e deritanishme për të parë shkallën

e përmbushjes dhe ndikimin e tyre. Lidhur me këtë Qeveria e ka publikuar një dokument, të cilin kryeministri Kurti e ka diskutuar edhe me deputetët e Kuvendit në një nga seancat e mbajtura.¹⁵ Në këtë diskutim janë evidentuar gabimet që kanë bërë qeveritë e kaluara gjatë arritjes së marrëveshjeve të dialogut, mirëpo kryeministri nuk ka treguar se si planifikon t'iu qaset këtyre marrëveshjeve të cilat veçse vazhdojnë të jenë prezente në terren tash e shumë vite. Në kuadër të dialogut me Serbinë që nga viti 2011 deri në vitin 2020 janë arritur gjithsej 35 marrëveshje duke përfshirë këtu marrëveshjet bazë, ato të rinegociuara dhe planet e zbatimit.¹⁶

Lidhur me përfshirjen e opozitës, thuhet se do të ketë bashkëbisedime të rregullta për të ndërtuar konsensus nacional në përgjithësi sa i përket politikës së jashtme, e në veçanti për raportin me Serbinë. Deri më tani kryeministri ka mbajtur takime me disa nga liderët e opozitës, mirëpo nga deklaratat pas takimeve nuk ka ende ndonjë përparim në ndërtimin e një pozicionin unik për këtë temë. Partitë opozitare janë shprehur se ende nuk e kanë të qartë se cili është pozicioni i qeverisë për dialogun dhe për këtë nuk janë njoftuar as në takimet e mbyllura.¹⁷ Arritja e konsensusit politik mbetet tejet e rëndësishme për ta çuar përpara procesin e dialogut në ruajtje të interesit nacional të Kosovës.

¹⁴ Shih programin e Qeverisë Kurti II në, <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2021/05/Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf>

¹⁵ Shih dokumentin e Qeverisë në mbi arritjet dhe sfidat në zbatimin e marrëveshjeve të dialogut në, http://votaim.org/Uploads/Data/Documents/RaportimbiarritjetdhesfidatnezbatimineMarrveshjesseBrukselit_Qershor2021_hnDJ3gw5FE.pdf

¹⁶ Shih të gjitha marrëveshjet e dialogut Kosovë-Serbi në, <http://votaim.org/Public/Dialog>

¹⁷ Shih të gjitha marrëveshjet e dialogut Kosovë-Serbi në, <http://votaim.org/Public/Dialog>

¹⁷ Shih deklaratat e përfaqësuesve opozitar në konferencën e KDI-së të mbajtur me 23 qershor 2021, në <https://fb.watch/6tcAmuSrfn/>

Në program përmendet disa herë rëndësia e koordinimit të ngushtë me SHBA-të. Ndërsa, synohet që pjesëmarrja e Kosovës në dialog duhet të bëhet duke u bazuar në përgatitje të mirëfilltë dhe dakordim të përbashkët për temat që duhet të bisedohen, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, partitë politike, si dhe ekspertë të fushës.¹⁸ Në fund, Qeveria në këtë program synon që dialogun ta zhvillojë mbi disa parime apo synime si njohja reciproke, njohja nga pesë vendet e BE-së si dhe anëtarësimi në OKB. Megjithatë, nuk ka sqarime se si mendohet që të arrihen këto qëllime, duke pasur parasysh që Kosova ende nuk njihet nga pesë vende anëtare të BE-së dhe anëtarë të Këshillit të Sigurimit si Rusia e Kina.

Në krahasim, programi i kaluar i Qeverisë 'Kurti 1', i dakorduar mes LVV-së e LDK-së, ka ofruar më shumë qartësi rreth qasjes dhe planeve ndaj dialogut sesa ky aktual.¹⁹ Në programin e ri nuk përmenden vijat e kuqe të Kosovës në dialog, miratimi i një rezolute/platforme për dialogun si dhe transparenca ndaj publikut e raportimi në Kuvend lidhur me dialogun. Kjo e fundit edhe pse nuk përmendet në program është obligim kushtetues i qeverisë, pasi që Kushtetua e mandaton Kuvendin si organin kryesor mbikëqyrës të politikës së jashtme. Rrjedhimisht kryeministri duhet të raportojë në Kuvend lidhur me këto procese, e në veçanti lidhur me dialogun.

Meqë programi ofron pak informacione lidhur me qasjen e kësaj qeverie ndaj dialogut, mbetet të shihet nëse qeveria do të hartojë një strategji dhe platformë për këtë proces dhe se a do t'i ndajë ato me Kuvendin dhe publikun.



Lidhur me përfshirjen e opozitës, thuhet se do të ketë bashkëbisedime të rregullta për të ndërtuar konsensus nacional në përgjithësi sa i përket politikës së jashtme, e në veçanti për raportin me Serbinë.

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Shih programin e kaluar të Qeverisë Kurti 1, pjesa për dialogun me Serbinë fq. 42-43 në, https://www.koha.net/uploads/files/2020/March/06/Programi_i_Qeverise_se_Kosoves_2020-2023_watermark1583513074.pdf

4. Përfundime dhe Rruga përpara

Ka qenë e pritshme që dialogu me Serbinë ashtu si edhe në të kaluarën do të ishte sfidë edhe për qeverinë aktuale. Me gjithë përpjekjet për t'a zhvendosur këtë çështje në fund të listës së prioriteteve, tashmë është evident fakti që dialogu do të vazhdojë të jetë një nga temat kryesore, deri sa ky proces të përmbyllet me një marrëveshje finale mes Kosovës dhe Serbisë.

Deri më tani Qeveria Kurti ka publikuar vetëm programin e saj të përgjithshëm qeverisës, në të cilin dialogut i është dhënë hapësirë marginale, pa u qartësuar se si do të jetë qasja ndaj këtij procesi. Programi nuk ofron shumë detaje se cilat do të jenë kërkesat e Kosovës në dialog, vijat e kuqe, temat të cilat do të ngriten, pritjet nga dialogu dhe se si do të zhvillohet ky proces në përgjithësi apo si do të arrihen objektivat e synuara. Ndërkohë qeveria ende nuk ka hartuar platformën dhe strategjinë për dialogun, ndërsa është zotuar se këto dokumente do të hartohen pas takimit të parë në Bruksel.

Në këtë takim që është zhvilluar mes kryeministrit Kurti dhe Presidentit Vuçiq më 15 qershor, kryeministri Kurti ka prezantuar katër propozime për vazhdimin e dialogut, të cilat janë refuzuar nga pala serbe. Në anën tjetër palës kosovare po i kërkohet themelimi i Asociacionit, për të cilin qeveria ka deklaruar se nuk mund të pranojë që ky mekanizëm të bëhet mbi baza etnike. Takimi i radhës i nivelit politik në Bruksel pritet të mbahet më 25 korrik. Deri atëherë nuk dihet se cilët do të jenë hapat e qeverisë ndaj dialogut, si do t'i qaset ajo çështjes së Asociacionit dhe cilat do të jenë kërkesat në takimin e korrikut.

Përparësitë e kësaj qeverie janë leksionet të cilat Kosova i ka marrë përgjatë procesit të dialogut të zhvilluar deri më tani, prandaj gabimet e njejtat nuk do duhej të përsëriteshin. Ndërsa mangësia është vetë faza në të cilën ka arritur ky proces, sepse është faza më komplekse meqë në fund të saj synohet arritja e një marrëveshje finale përmbylëse.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile janë të mendimit se pala kosovare duhet të insistojë që marrëveshja finale mes Kosovës dhe Serbisë të jetë e bazuar në një 'model evropian' që ka funksionuar dhe i ka qëndruar testit të kohës. Ndërsa për arritjen e kësaj marrëveshje duket se momentum i duhur për Kosovën është tani.²⁰

Nevoja për koordinim dhe konsensus: Kapitulli i ri i dialogut e gjen Kosovën me një konstalacion të ri politik, i cili konsiston në një qeveri të udhëhequr nga LVV, parti kjo e cila ka qenë në parim kundër negociatave me Serbinë qysh para fillimit të këtij procesi. Ndërsa, në opozitë janë subjektet politike LDK, PDK dhe AAK, të cilat kanë udhëhequr qeverinë dhe dialogun me Serbinë përgjatë periudhave të caktuara.

Për momentin duket se ka koordinim mes kryeministrit Kurti dhe presidentes Osmani sa i përket dialogut. Ky koordinim duhet të vazhdojë në secilin raund të dialogut, ashtu siç e parasheh edhe Kushtetuta e vendit. Mirëpo, përpjekjet për ndërtimin e një konsensusi të gjerë jo vetëm politik por edhe shoqëror mbeten të nevojshme për ta përmbyllur këtë proces.²¹ Fillimisht **për të fuqizuar pozicionin e Kosovës**, por edhe për të siguruar **mbështetje për marrëveshjen finale**, e cila për të kaluar procesin e ratifikimit i duhen 2/3 e votave në Kuvend. Kjo sepse

20 Shih deklaratën e drejtorit ekzekutiv të Institutit Epik z.Demush Shasha në konferencën e KDI-së të mbajtur më 23 qershor 2021 në, <https://fb.watch/6tcAmuSrfn/>

21 Shih deklaratat e panelistëve në konferencën e KDI-së të mbajtur më 23 qershor 2021 në, <https://fb.watch/6tcAmuSrfn/> dhe <https://fb.watch/6teq9XM8DV/>

tashmë kemi parë krizat që mund të shkaktojnë marrëveshjet për të cilat paraprakisht nuk është arritur një mbështetje brenda vendit, siç ka qenë rasti me marrëveshjen e 19 prillit 2013 dhe atë të 25 gushtit 2015 për demarkacionin me Malin e Zi.

Krizat politike e institucionale që janë shkaktuar si rezultat i mospajtimeve për dialogun mund të përsëriten sërish, nëse as në këtë fazë nuk arrihet një unitet i spektrit të gjerë politik. Duke pasur parasysh këtë, kryeministri si bartës i procesit të dialogut dhe presidentja si faktor i unitetit, duhet të përpiqen të ndërtojnë unitet politik dhe konsensus të gjerë për dialogun me qëllim të fuqizimit të pozicionit të Kosovës, por edhe sigurimit të mbështetjes për marrëveshjen finale.²² Në anën tjetër, duke pasur parasysh kompleksitetin e kësaj faze të dialogut dhe rëndësinë e saj për interesin nacional të Kosovës, spektri politik duhet të lë anash kalkulimet partiake dhe të synojë që Kosova në këtë proces të prezantohet me një qëndrim sa më unik. **Në të kundërtën vazhdimi i përçarjeve politike do të vazhdojë ta dëmtojë pozicionin e Kosovës në dialog.**

Prandaj, Qeveria dhe Kryeministri si bartës të dialogut duhet të vazhdojnë me iniciativat dhe përpjekjet për të siguruar unitet lidhur me këtë proces. Në këtë drejtim, konsensusi duhet të arrihet fillimisht për pikat që i përbashkojnë të gjitha partitë dhe pastaj të tentohet që të gjendet pajtueshmëri edhe për pikat ku qeveria dhe opozita kanë qëndrime të ndryshme. Platforma dhe Strategjia për dialogun mund të jenë mënyra e duhur për artikullimin e një pozicioni të përbashkët të spektrit politik për dialogun. Rrjedhimisht, Qeveria duhet të hartojë platformën dhe strategjinë për dialogun, duke i përfshirë në këtë proces edhe partitë opozitare. Në procesin e hartimit të këtyre dokumenteve kontribut mund të ofrojnë edhe shoqëria civile dhe akademia e shkencave.

Si mënyrë për të siguruar përkrahje të gjerë politike për dialogun me Serbinë, Qeveritë e kaluara kanë praktikuar propozimin e rezolutave në Kuvend gati para çdo faze të këtij procesi. Këto rezoluta të cilat janë miratuar në Kuvend kanë përcaktuar parimet mbi të cilat duhej të zhvillohej dialogu. Mirëpo, disa nga këto rezoluta me apo pa vetëdije kanë

tejkalluar mandatin e Kuvendit si institucion mbikëqyrës, duke ndërhyrë në mandatin e Qeverisë.²³ Kjo sepse disa prej tyre kanë synuar të autorizojnë qeverinë për të udhëhequr me dialogun. Prandaj nëse mendohet të iniciohet një rezolutë e re për dialogun, përmbajtja e saj duhet të jetë në përputhje me dispozitat kushtetuese në fuqi dhe të respektojë parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

Përderisa rezolutat e Kuvendit nuk janë obliguese për Qeverinë, Kushtetuta e përcakton Kuvendin si institucionin mbikëqyrës ndaj procesit të dialogut dhe politikës së jashtme në përgjithësi. Rrjedhimisht, qeveria/kryeministri e kanë obligim kushtetues që të raportojnë në Kuvend lidhur me veprimet në politikën e jashtme/dialogun në përputhje me dispozitat kushtetuese të kontrollit dhe balancimit të pushteteve. Deri më tani kryeministrat e kanë praktikuar raportimin në Kuvend lidhur me dialogun qoftë para apo pas takimeve të zhvilluara në kuadër të dialogut. Deri më tani këto raportime kanë qenë kryesisht sipërfaqësore, ndërsa kryeministrat janë arsyetuar në nevojën për të ruajtur konfidencialitetin e negociatave. Si rrjedhojë, deputetët nuk kanë arritur të garantojnë transparencë dhe llogaridhënie të procesit të dialogut, ndërsa edhe përgatitja e tyre për temat e dialogut, ka qenë e pamjaftueshme për të sfiduar qeverinë. Kjo situatë po vazhdon edhe në legjislaturën e re që po karakterizohet me një qeveri të rezervuar në dhënien e informacioneve lidhur me dialogun. Përballë saj është një opozitë e cila nuk është treguar mjaftueshëm proaktive në garantimin e transparencës dhe llogaridhënies së ekzekutivit lidhur me këtë çështje. Në anën tjetër edhe vetë qëndrimet e opozitës lidhur me këtë proces jo gjithmonë përkrijnë me qasjen që ato kanë mbajtur në kohën kur kanë qenë në qeveri dhe kanë udhëhequr me dialogun. E gjithë kjo pasqyrë tregon se qasja ndaj temës së dialogut po vazhdon të bazohet mbi kalkulime partiake dhe konsensusi i shumëkërkuar mbetet vështirë i arritshëm.

²² Po aty.

²³ Shih rezolutat e Kuvendit për dialogun me Serbinë, <http://www.votaim.org/Public/DraftLaws#resolutions>



Përfaqësuesit e shoqërisë civile janë të mendimit se pala kosovare duhet të insistojë që marrëveshja finale mes Kosovës dhe Serbisë të jetë e bazuar në një 'model evropian' që ka funksionuar dhe i ka qëndruar testit të kohës. Ndërsa për arritjen e kësaj marrëveshje duket se momentum i duhur për Kosovën është tani.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA